



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:224054

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05437439

**P.nr.751/2023**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, në çështjen penale ndaj të pandehuri N. I. nga fshatin R., Komuna e V., për shkak të veprës penale: ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-ës, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokatin Sh. Sh., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr..../2023, të datës 24.10.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 14.02.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datë 12.03.2024 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri N. I., nga babai A., nëna B., e gjinisë Sh., i lindur me datë ....., në fshatin R., Komuna e V., ku edhe jeton, i martuar, baba i .... fëmijëve pensionist, ka të kryer shkollën e lartë, me gjendje te mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 22.09.2023, në kohën e papërcaktuar, në Gjilan, më saktësisht në lagjen afër Dardanies I te PRU “Qeshmja e Petigovcit”, inspektorët e ndërtimit të Komunës së Gjilanit gjatë inspektimit në terren, kanë has dhe konstatuar se, i pandehuri N. I., si investitor dhe pronar i objektit në ndërtim dhe përgjegjës i drejtpërdrejtë, ka ndërtua-objektin,-kati i fundit, në parcelën me nr.....-... dhe .....-..., duke tejkalluar lejen e ndërtimit nr.07-.../...../23, me çka ka ndërmarrë veprime që bien ndesh me nenin 14 të Ligjit për ndërtim me Nr. 04/L-110, ashtu që, ka filluar me ndërtimin në objektin, pa u pajisur me leje të ndërtimit, si dhe nuk ka respektuar aktvendimin me nr. ...-.../03-...../...-.. të datës 26.09.2023, nga Inspekcioni i Ndërtimit në Komuna e Vitisë, për ndërprerjen e punimeve deri në sigurimin e lejes ndërtimore nga organet kompetente, por për kundër kësaj, i njëjti, pa leje dhe autorizim, në kundërshtim me vendimet e organeve kompetente komunale ka vazhduar ndërtimin e objektit pa leje ndërtimi, dhe përsëri gjatë inspektimit, është vërtetua se i njëjti, ka vazhduar punimet, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të kundërligjshme ka rrezikuar sigurinë e përgjithshme që kanë të bëjnë me rregullat e ndërtimit,

**me çka ka krye veprën penale, Ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-ës.**

**-II-**

Sepse me datë, 26.09.2023 dhe vend si në dispozitivin e parë, i pandehuri N. I., ka hequr dhe dëmtuar shenjën zyrtare, përkatësisht shiritat e vendosur nga inspektorët e ndërtimit të Komunës së Gjilanit, me çka nuk lejohet të ndërtohet asnjë punë shtesë, i njëjti përkundër kësaj ka vazhduar aktivitetin e kundërligjshëm në ndërtim të objektit, në këtë mënyrë i pandehuri ka ndërmarrë veprime të kundërligjshme duke rrezikuar dukshëm sigurinë e përgjithshme.

**-me çka kishte me kryer vepër penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 i KPRK-së.**

Andaj, në bazë të neneve 4, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-s, dhe neneve 242 e 364 të KPP-s, të pandehurin e lartcekur :

**E GJYKON**

**I.** Për veprën penale sipas dispozitivit I, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit, në kuptim të nenit 44 para 1 të KPRK-së, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1000.00 (njëmijë -euro)€, dhe me dënim me gjobë në shumën prej 500 € (pesëqind-euro), të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguajë nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

**II.** Për veprën penale sipas dispozitivit II, i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind-euro)€,

Ndërsa dënimi uni i dënimit me gjobë, të pandehurit i shqiptohet në shumë prej 800.00 (tetëqind euro) € të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguajë nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

**III.** Në kuptim të nenit 76 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të KPRK-së, të akuzuarin e lartcekur e gjykon me dënim unik me gjobë në shumë prej 1800.00€(njëmijetëqind-euro)€, të cilin dënim do ta paguajë në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë.

Nëse i pandehuri i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzetë- euro)€ do ti caktohet nga një ditë burgim.

Obligohet i pandehuri, që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### Rrjedha e çështjes dhe fjalët përfundimtare të palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 25.10.2023, ka dorëzuar në këtë gjykatë aktakuzën me numër PP.II.nr..../2023, të datës 24.10.2023, ndaj të pandehurit N. I. nga fshati R., Komuna e Vitisë për shkak të veprave penale: ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-ës, heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-ës.

Me datë 12.02.2024, Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, të arritur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan në njërën anë dhe të pandehurit N. I., me mbrojtësin e tij në anën tjetër, sipas të cilës marrëveshje kësaj gjykate i është rekomanduar që të pandehurit për shkak të veprave penale të lartcekura, të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit, në kuptim të nenit 44 para 1 të KPRK-së, **i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1000.00 (njëmijë -euro)€, dhe me dënim me gjobë në shumën prej 500 € (pesëqind-euro),** të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguajë nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë. Për veprën penale sipas dispozitivit II, i shqipton dënim me gjobë **300(treqind-euro)€, të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguajë nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.** Në kuptim të nenit 76 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të KPRK-së, të akuzuarin e lartcekur e gjykon me dënim unik me gjobë në shumë **prej 800 (tetëqind-euro) dhe me dënimin e zëvendësuar me burg në shumë prej 1000.00€, e gjithsejte i shqiptohet dënimi në shumë prej 1800.00(njëmijetetëqind-euro)€,** andaj gjykata ka caktuar seancën dëgjimore lidhur me marrëveshjen e pranimit të fajësisë me datë 14.02.2024, ku kanë prezantuar, prokurorja e shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, në të cilën seancë gjykata pasi që ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore, ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

### Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në bazë të nenit 230 të KPP-ës. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e arritur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan si dhe të akuzuarit, i përmbush të gjitha kushtet ligjore si dhe se e njëjta është arritur në bazë të nenit 230 të KPP-ës, po ashtu gjykata ka konstatuar faktin se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 242 paragrafi 1 .p.1.6 të KPP-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë qenë prezentë palët e lartcekura gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilat akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 258 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit si dhe njoftimit të sajë lidhur me pasojat dhe bene fitet e

pranimi të fajësisë, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Procesverbal mbi inspektimin nga Inspektori i ndërtimit me nr. ...., procesverbal mbi inspektimin me nr. .... i datës 04.10.2023, dhe i datës ..... i datës 22.09.2023 fotografi nga vendi i ngjarjes, urdhëresë për pagesë për ndëshkim me gjobë mandatorë me nr....., aktvendim për ndërprerjen e punëve nga Drejtoria e Inspeksionit me nr. .... i datës 26.09.2023, aktvendim për rrënim me nr.....të datës.11.09.2023. urdhëresë për pagesë për ndëshkim me gjobë mandatorë me nr serik. ...., si dhe shkresat e tjera të lëndës. Po ashtu me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### **Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari i ka kryer veprat penale: ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-ës, heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-ës, si në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 71 paragrafi 1, nën paragrafi 3 të KPRK-ës, ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me gjobë dhe dënim me burgim por me pëlqimin e të pandehurit dhe komform nenit 44 të KPRK-së, dënimi me burgim ti zëvendësohet me dënim gjobe në shumë prej 1000.00 €, si dhe dënim me gjobë 500€ për dispozitivin e I dhe për dispozitivin e dyte dënim me gjobe 300€, ku të akuzuarin e lartcekur e gjykon me dënim unik me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind-euro) € 1800.00€(njëmijetetëqind-euro)€, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryerësit.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata mori pranimin e fajësisë, përkatësisht faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në një stad të hershëm të saj edhe kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me prokuroren e shtetit në një fazë të hershme të procedurës penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale të cilën gjykata e mori si reale, keqardhjen e shfaqur, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të akuzuarit.

### **Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit, duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin i tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit

shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

**Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit gjyqtarja e vetme gjykuese duke u bazuar në nenin 450 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që ta obligojë ti paguajnë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 euro, si dhe shumën prej 20 euro, për kompensimin e viktimave të krimit edhe atë në kuptim të nenit 39 paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensim e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**P.nr.751/2023,  
me datë 12.03.2024**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,  
Mevlide Shabani**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.